



DEKLARATË PUBLIKE
NË LIDHJE ME FORUMET PUBLIKE
'POP 2017 – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2017

Tiranë, qershor 10, 2017. "POP 2017 – Përballja e Ofertave Politike" është një nismë që nxit përballjen publike në lidhje me platformat e të gjitha partive politike që marrin pjesë në fushatën parlamentare zgjedhore të 25 qershorit 2017, në Shqipëri. Kjo nismë përsërit forumet e mëparshme të realizuara në prag të zgjedhjeve 2013 dhe 2015.

Aktivitetet e vitit 2017 përfshijnë organizimin e nëntë forumeve publike me kandidatë për deputetë në nëntë qytete të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Vlorë, Kukës, Shkodër, Pogradec dhe Pukë.

Forumet publike kanë për qëllim të nxisin kulturën demokratike dhe synojnë të sigurojnë një hapësirë të hapur, të lirë dhe të barabartë për përfaqësuesit e partive politike për të paraqitur platformat e tyre dhe për të diskutuar me qytetarët mbi prioritetet, nevojat dhe shqetësimet e tyre për komunitetin. Ky format nuk ka për qëllim të lehtësojë debatin midis partive politike.

Në forumet publike që janë realizuar deri më sot, organizatorët kanë ftuar zyrtarisht përfaqësues nga partitë e ndryshme politike duke përfshirë Partinë Socialiste (PS), Partinë Demokratike (PD), Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI), Partinë LIBRA, Partinë për Integrimin e Drejtësisë dhe Unitetin (PDIU), dhe Partinë SFIDA.

Forumi i parë publik në Vlorë kishte përfaqësimin e të gjitha partive. Por papritur organizatorët e forumeve u përballën me vendimet e disa partive të cilat kanë preferuar të kenë forume të veçanta pa praninë dhe pjesëmarrjen e kandidatëve nga partitë e tjera politike.

Për këtë arsye, organizatorët po lëshojnë këtë deklaratë dhe sqarojnë publikun e gjerë dhe partitë politike se qëllimi i nismës sonë është të ofrojmë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët për paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët.

Ne nuk inkurajojmë ndasi politike të cilat nuk ndihmojnë apo mbështetin kulturën demokratike. Debatet midis të gjithë kandidatëve rrisin aftësinë e politikanëve të komunikojnë në mënyrë civile me qytetarët. Për ne të rëndësishëm janë qytetarët. Kjo është mundësi që u jepet partive politike të paraqesin programin e tyre e të tregojnë sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Si dhe për qytetarët që të kenë mundësi të komunikojnë shqetësimet e tyre dhe të kërkojnë përgjegjshmëri politike.

Për këtë arsye, ne e mbajmë ftesën të hapur dhe ftojmë partitë politike që të paraqesin programet e tyre për qytetarët si dhe jemi të gatshëm të ofrojmë hapësirë në forumet publike sipas kërkesave e mundësive të tyre.

Rrjeti i Organizatave¹:

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim në Tiranë
Shtëpia e të Drejtave të Njeriut/ CRCA në Tiranë
Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin / Qendra Aulona – Vlora
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Tiranë
Epoka e Re, Fier
Intelektualët e rinj “Shpresë” – Shkodër
Lëvizja Rinore, Pukë
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës
Qendra Rinore Vlorë;
Qendra Rinore për progres, Kukës
Rinia per Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim., Pogradec
Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri

